



*SHËRBIME KONTABILITETI DHE AUDITIMI*  
*ACCOUNTING AND AUDITING SERVICES*

NUI: 810593493

Zyra: Rr. "Edit Durham" Nr. 115, H9/67. 20000 Prizren  
Mob: 044/ 187 305; e-mail: kadrushcollaku@hotmail.com

---

## **OJQ "NEVO KONCEPTI"**

**PRIZREN, KOSOVË**

**RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**DHE**

**PASQYRAT FINANCIARE**

**Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024**

**Prill 2025**

**PËRMBAJTJA**

|                                                                    |    |
|--------------------------------------------------------------------|----|
| RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR.....                               | 3  |
| PASQYRAT FINANCIARE .....                                          | 5  |
| PASQYRA E TË ARDHURAVE.....                                        | 5  |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR – BILANCI I GJENDJES .....          | 6  |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE .....                               | 7  |
| PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË .....                                 | 7  |
| SHËNIME SHPJEGUESE DHE POLITIKAT KONTABËL .....                    | 8  |
| 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME .....                                 | 8  |
| 2. POLITIKAT KONTABËL .....                                        | 10 |
| SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE.....                    | 13 |
| 3. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË.....                           | 13 |
| 4. PARAPAGIMET TJERA .....                                         | 13 |
| 5. LLOGARTITË E PAGUESHME DHE TË TJERA.....                        | 13 |
| 6. FONDET.....                                                     | 14 |
| 7. TË ARDHURAT .....                                               | 14 |
| 8. SHPENZIMET PROGRAMORE .....                                     | 14 |
| 9. SHPENZIMET E ADMINISTRATËS DHE MENAXHMENTIT .....               | 15 |
| 10. NGJARJET PAS DATËS SË PËRPILIMIT TË RAPORTEVE FINANCIARE ..... | 15 |
| 11. APROVIMI I PASQYRAVE FINANCIARE .....                          | 15 |
| <i>Shtojca 1</i> .....                                             | 16 |

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Për: Bordin e drejtorëve të OJQ "NEVO KONCEPTI", Prizren**

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ "NEVO KONCEPTI", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në fonde për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të OJQ "NEVO KONCEPTI" prezantojnë në mënyrë të drejtë dhe të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të OJQ "NEVO KONCEPTI", performancën financiare si dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 në përputhje me bazat e përpilimit të raportimit financiar të përshkruara në paragrafin 2.1 të këtij raporti.

### *Baza për opinionin*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### *Çështje të tjera*

Pasqyrat financiare të OJQ "NEVO KONCEPTI" për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar, përkundër disa gabimeve, të cilat janë korrigjuar dhe pasqyrat janë rishpallur.

***Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me raportet financiare***

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Raportimit Financiar të zbatueshme në Kosovë, dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë shoqërinë ose të ndërpres aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

***Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare***

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim, i kryer sipas SNA-ve, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësiave të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare gjendet në ***Shtojcën 1*** të këtijë raporti. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

Kadrush Çollaku, Auditor ligjor

"K&M" Shërbime Kontabiliteti dhe Auditimi

28 Prill 2025

## PASQYRAT FINANCIARE

## PASQYRA E TË ARDHURAVE

| OJQ "Nevo Koncepti" Prizren                                                               |          |                |                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|----------|----------------|-----------------------|
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse<br>për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2024 |          |                |                       |
| Të ardhurat                                                                               | Shënimi  | 2024<br>Euro   | 2023<br>Euro          |
| Të hyrat nga grantet dhe donacionet                                                       |          | 291,132        | Rishpallur<br>174,244 |
| Të hyrat tjera                                                                            |          | 377            | 589                   |
| <b>Gjithsej të ardhurat bruto</b>                                                         | <b>7</b> | <b>291,509</b> | <b>174,833</b>        |
| <b>Shpenzimet</b>                                                                         |          |                |                       |
| <b>Shpenzimet programore</b>                                                              |          |                |                       |
| Pagat dhe mëditjet bruto                                                                  |          | 129,237        | 18,549                |
| Shpenzimet programore                                                                     |          | 72,020         | 34,144                |
| Të tjera                                                                                  |          | 7,624          | -                     |
| <b>Gjithsej shpenzimet programore</b>                                                     | <b>8</b> | <b>208,881</b> | <b>52,693</b>         |
| <b>Menaxhment dhe administratë</b>                                                        |          |                |                       |
| Pagat dhe mëditjet bruto                                                                  |          | 26,979         | 69,268                |
| Shpenzimet operative                                                                      |          | 22,661         | 9,749                 |
| Të tjera                                                                                  |          | 24,912         | 101                   |
| <b>Gjithsej shpenzimet menaxhment dhe administratë</b>                                    | <b>9</b> | <b>74,552</b>  | <b>79,118</b>         |
| <b>Shpenzimet tjera</b>                                                                   |          | <b>800</b>     | <b>5,066</b>          |
| <b>Gjithsej shpenzimet tjera</b>                                                          | <b>9</b> | <b>800</b>     | <b>5,066</b>          |
| <b>Gjithsej shpenzimet</b>                                                                |          | <b>284,233</b> | <b>136,877</b>        |
| <b>Net rritje / pakësim nga operacionet</b>                                               |          | <b>7,276</b>   | <b>37,956</b>         |
| <b>Shpenzimet e tatimit në fitim</b>                                                      |          | <b>-</b>       | <b>-</b>              |
| <b>Net rritje / pakësim i fondeve të periudhës</b>                                        |          | <b>7,276</b>   | <b>37,956</b>         |
| Net rritje / pakësim i fondeve nga periudhat e kaluara                                    |          | 42,150         | 4,194                 |
| Kthim i fondeve                                                                           |          | -              | -                     |
| Shlyerjet e inventarit dhe korigjimet                                                     |          | -              | -                     |
| <b>Fondet e mbajtura në fund të vitit</b>                                                 | <b>6</b> | <b>49,426</b>  | <b>42,150</b>         |

Këto pasqyra financiare janë përgatitur, aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti i OJQ-së

Përgatitur nga: Vildane Luma

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Aprovuar nga: Osman Osmani

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

NEVO  
KONCEPTI

Datë:

31/03/2025

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR – BILANCI I GJENDJES

| OJQ "Nevo Koncepti" Prizren                                                                    |          |               |               |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|---------------|---------------|
| Pasqyra e pozitës financiare - Bilanci i gjendjes<br>për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 |          |               |               |
| PASURITË                                                                                       | Shënim   | 2024<br>Euro  | 2023<br>Euro  |
| <b>Pasuritë afatshkurtëra</b>                                                                  |          |               | Rishpallur    |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë                                                               | 3        | 50,822        | 43,546        |
| Parapagimet tjera                                                                              | 4        | 304           | 120           |
| <b>Gjithsej pasuritë afatshkurtëra</b>                                                         |          | <b>51,126</b> | <b>43,667</b> |
| <b>Pasuritë afatgjata</b>                                                                      |          |               |               |
| Prona, pajisjet dhe impiantet                                                                  |          | -             | -             |
| <b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>                                                             |          | <b>-</b>      | <b>-</b>      |
| <b>GJITHSEJ PASURITË</b>                                                                       |          | <b>51,126</b> | <b>43,667</b> |
| <b>FONDET DHE DETYRIMET</b>                                                                    |          |               |               |
| <b>Detyrimet afatshkorta</b>                                                                   |          |               |               |
| Llogaritë e pagueshme dhe te tjera                                                             | 5        | 1,700         | 1,517         |
| <b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>                                                          |          | <b>1,700</b>  | <b>1,517</b>  |
| <b>Detyrimet afatgjata</b>                                                                     |          |               |               |
| <b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>                                                            |          | <b>-</b>      | <b>-</b>      |
| <b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>                                                                      |          | <b>1,700</b>  | <b>1,517</b>  |
| <b>FONDET</b>                                                                                  |          |               |               |
| Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara                                          |          | 42,150        | 4,194         |
| Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese                                             |          | 7,276         | 37,956        |
| Kthim i fondeve donatoreve                                                                     |          | -             | -             |
| <b>Gjithsej fondi</b>                                                                          | <b>6</b> | <b>49,426</b> | <b>42,150</b> |
| <b>GJITHSEJ FONDET DHE DETYRIMET</b>                                                           |          | <b>51,126</b> | <b>43,667</b> |

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE

| OJQ "Nevo Koncepti" Prizren               |                      |                       |                     |          |
|-------------------------------------------|----------------------|-----------------------|---------------------|----------|
| Pasqyra e ndryshimeve në fonde            |                      |                       |                     |          |
| për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024 |                      |                       |                     |          |
|                                           | Fondet<br>fillestare | Fondet e<br>akumuluar | Rezervat<br>e tjera | Gjithsej |
|                                           | Euro                 | Euro                  | Euro                | Euro     |
| <b>Gjendja më 1 Janar 2023</b>            | -                    | 4,194                 | -                   | 4,194    |
| Net rritje / pakësim nga operacionet      |                      | 37,956                |                     | 37,956   |
| <b>Gjendja më 31 Dhjetor 2024</b>         | -                    | 42,150                | -                   | 42,150   |
| Net rritje / pakësim nga operacionet      |                      | 7,276                 |                     | 7,276    |
| <b>Gjendja më 31 Dhjetor 2024</b>         | -                    | 49,426                | -                   | 49,426   |

## PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

| OJQ "Nevo Koncepti" Prizren                                          |        |               |               |
|----------------------------------------------------------------------|--------|---------------|---------------|
| Pasqyra e rrjedhës së keshit (parasë)                                |        |               |               |
| për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2024                            |        |               |               |
|                                                                      | Shënim | 2024<br>Euro  | 2023<br>Euro  |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>                    |        |               |               |
| Fitimi / (humbja) i / e vitit                                        |        | 7,276         | 37,956        |
| <b>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</b> |        |               |               |
|                                                                      |        | -             | -             |
| (Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera                             |        | (184)         | (45)          |
| Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të        |        | 183           | 147           |
|                                                                      |        | (1)           | 102           |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>               |        | <b>7,276</b>  | <b>38,058</b> |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>                   |        |               |               |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>              |        | -             | -             |
| <b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>                   |        |               |               |
| Fondet e kthyer                                                      |        | -             | -             |
| <b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>              |        | -             | -             |
| <b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>  |        | <b>7,276</b>  | <b>38,058</b> |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit                  |        | 43,547        | 5,489         |
| <b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>             |        | <b>50,822</b> | <b>43,547</b> |

## SHËNIME SHPJEGUESE DHE POLITIKAT KONTABËL

### 1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

OJQ NEVO KONCEPTI është organizatë jo-qeveritare dhe jo-profitabile e themeluar sipas Ligjit Nr. 06/1-43, Neni 15 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit rom të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj. Është regjistruar si organizatë joqeveritare më 26 nëntor 2014 me Nr. të regjistrimit 5115293-0 dhe Nr. Fiskal: 601188700.

**Adresa e regjistrimit:** Rr." Adnan Krasniqi" 149 hyrja II/8, Prizren

**Themeluesit:** Erxhan Galushi, Edon Korllari, Nurgjan Qorri.

**Kryesues i bordit të OJQ:** Daut Qylangji

**Përfaqësues i OJQ-së:** Zt. Osman Osmani, drejtor ekzekutiv

### MISIONI, QËLLIMI DHE AKTIVITETET E ORGANIZATËS

#### *Misioni i "NEVO KONCEPTI":*

Misioni OJQ "Nevo Koncepti" është që të angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë mbrojtja e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas, përmes promovimit dhe ndikimit në zhvillimin e politikave publike në favor të grupeve të cënueshme të shoqërisë.

#### *Aktivitetet "NEVO KONCEPTI"*

Gjatë vitit 2024 OJQ "NEVO KONCEPTI" ka operuar me programet si më poshtë:

**1. "Promovimi dhe Realizimi i të Drejtave të Romëve në Kosovë dhe Shqipëri"** është projekt i implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Nevo Kocepti (NVK)/Kosovë dhe Drejtësi Sociale (DS)/Shqipëri, në partneritet me Karl Kubel Stiftung (KKS), dhe me përkrahje financiare të Ministrisë Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ).

Kohëzgjatja e projektit: 01.11.2023 – 30.04.2027.

Përmes këtij projekti, në bashkëpunim me akterët relavant, synohet që të avokohet për të drejtat e komuniteti rom në arsim, punësim dhe shëndetësi, si dhe të fuqizohet shoqëria civile në ndikimin për ndryshim dhe hartim të politikave publike në nivel qendror dhe lokal, në përmisim të mirëqenies së komunitetit rom.

**2."Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve"** - është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA).

Kohëzgjatja e projektit: 01.06.2022 – 31.09.2025

Qëllimi i projektit është që nepërmjet Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Prizren të avokohet për të drejtat e fëmijëve dhe përfshirjen e fëmijëve në qeverisje, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje, në hartimin dhe zbatimin e politikave të cilat janë në funksion të fëmijëve.

**3."Fuqizimi i Komuniteteve të Cenueshme të Kosovës Përmes Qasjes më të Mirë dhe të Barabartë në Tregun e Punës"** i implementuar nga OJQ "Nevo Koncepti" në partneritet me Save the Children në Kosovë, financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim(ADA).

Kohëzgjatja e projektit: 01.10.2023 - 30.09.2026.

Qëllimi i projektit është fuqizimi vajzave dhe djemve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian duke mbështetur në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe mundësi të nevojshme për një tranzicion të suksesshëm për moshat madhore dhe punë dinjëtoze të qëndrueshëm në Prizren, Gjakovë dhe Fushë Kosovë.

**4. "Përmirësimi i gjendjes së arsimit të fëmijëve Rom, Ashkali, Egjiptian dhe të tjerë",** i implementuar nga OJQ Nevo Koncepti dhe i financuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë.

Kohëzgjatja e projektit: 01.09.2024 deri më 30.04.2025

Qëllimi i projektit është që të ndikojë direkt te nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian duke përmirësuar vijueshmërinë, duke ndikuar në parandalimin e braktisjes, ngritjen e suksesit të nxënësve me probleme në mësimnxënje, socializimin e fëmijëve dhe ngritjen e ndërgjegjësimit të prindërve ndaj shkollimit të fëmijëve. Projekti realizohet në tre shkolla fillore të komunës së Prizrenit.

**5. "Rritja e Përfshirjes në Edukimin Parashkollor dhe Fillor"** të zbatuar në bashkëpunim me Qendrë për Arsimit të Kosovës (KEC) dhe Visioni 02, dhe financuar nga Bashkimi Evropian dhe Roma Education Fund (REF).

Kohëzgjatja e projektit: 12.01.2024 - 30.06.2026.

Projekti ka për qëllim të përmirësojë rezultatet e zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe vijimin e shkollimit nga fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian të moshave 4-6 dhe 6-8 vjeç në 7 lagje të banuara me familje rome.

## 2. POLITIKAT KONTABËL

### 2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L-043 që aktualisht janë në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe mbi bazën e kontabilitetit të përcaktuar në marrëveshjen me donatorët duke përfshi këtu edhe buxhetimin. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike dhe bazës së moderuar të keshit, ku të ardhurat njihen kur ato inkasohen e jo kur ato fitohen, ndërsa shpenzimet njihen kur ato paguhen e jo kur ato ndodhin. Modifikimi i bazës së keshit bëhet vetëm për shpenzimet e grumbulluara në fund të periudhës së raportimit.

### 2.2 Sistemi i kontabilitetit

OJQ - NEVO KONCEPTI përdorë sistemin e kontabilitetit të zhvilluar nga "Log Micro", i cili prodhon raporte të mjaftueshme financiare siç janë: libri i arkës, libri i bankës, librin kryesor, raportet e të hyrave dhe shpenzimeve për projekte si dhe pasqyrat financiare të OJQ-së si tërësi.

### 2.3 Rregulloret e brendshme

NEVO KONCEPTI në momentin e auditimit kishte në zbatim rregulloret e brendshme të organizatës si më poshtë:

1. Rregulloren e financave
2. Rregulloren e punës
3. Rregullorja për parandalim dhe mbrojtje nga ngacmimet seksuale në vendin e punës

## 2.4 Valuta raportuese dhe prezantimi

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe prezantuar në valutën EURO, e cila njëherit është valuta funksionale dhe legale në Republikën e Kosovës.

## 2.5 Vijimësia

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, sipas së cilës shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë dhe detyrimet e saja në rrjedhën normale të biznesit.

## 2.6 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë: Paranë në arkë dhe depozitat rrjedhëse të mbajtura në bankat vendore.

## 2.7 Llogarite e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

## 2.8 Punonjësit dhe përfitimet

Përgjatë kohës së auditimit të gjithë të punësuarit nga OJQ "NEVO KONCEPTI-së" kishin kontrata të rregullta dhe valide bazuar në rregulloret dhe politikat e brendshme të Organizatës dhe në pajtueshmëri me Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës. OJQ kontribuon vetëm me kontribute për pensione të detyrueshme që përcaktojnë përfitime pensionale për punëtorët pas pensionimit.

## 2.9 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga grantet dhe donacionet njihen si e hyrë në momentin e inkasimit të tyre, duke e ndarë më pastaj atë, në të hyrat e periudhës raportuese dhe të hyrat e shtyra që i takojnë periudhave të ardhshme raportuese. Të hyrat nga aktivitetet ekonomike (nëse ka) njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur si dhe shërbimet janë kryer.

Shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera njihen në baza akruale që d.m.th shumica e tyre kur ato paguhen dhe një pjesë e vogël (të parapara në projekte i shpërndahen periudhës raportuese). Shumat e të hyrave të pranuara prezantojnë kontributin financiar të aprovuar nga donatorët për të mbështetur shpenzimet e zhvillimit të projekteve dhe mbarrëvajtjes së operacioneve dhe një pjesë e vogël nga vetëkontributet.

## 2.10 Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria është organizatë jo-profitabile dhe nuk shpërndanë fitim, kështu që sipas legjislacionit në fuqi nuk është subjekt i tatimit në të fitim.

## SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE

## 3. PARAJA DHE EKUVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentët e parasë pasqyrojnë paranë në bankë dhe arkë, më 31 Dhjetor 2024 përbëhet nga si më poshtë:

| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | Me 31 Dhjetor 2024 | Me 31 Dhjetor 2023 |
|----------------------------------|--------------------|--------------------|
| Arka                             | -                  | -                  |
| <b>Gjithsej paraja në arkë</b>   | -                  | -                  |
| 150020500016373-85 ADA           | 6,202              | 45                 |
| 150020500019825-11 SIDA          | 178                | 36                 |
| 150020500015887-88 NEVO          | 1,359              | 5,171              |
| 150020500018356-53 MASHT         | 15,169             | 35,293             |
| 150020010056048-96 KKS           | 20,656             | 3,001              |
| 15020500020068-50 KEC            | 7,258              | -                  |
| <b>Gjithsej paraja në bankë</b>  | <b>50,822</b>      | <b>43,546</b>      |
| <b>Gjithsej paraja</b>           | <b>50,822</b>      | <b>43,546</b>      |

## 4. PARAPAGIMET TJERA

Parapagimet tjera përbëhen nga si më poshtë:

| Parapagimet tjera | Me 31 Dhjetor 2024 | Me 31 Dhjetor 2023 |
|-------------------|--------------------|--------------------|
| Parapagimet tjera | 304                | 120                |
| <b>Gjithsej</b>   | <b>304</b>         | <b>120</b>         |

## 5. LLOGARTITË E PAGUESHME DHE TË TJERA

Më 31 Dhjetor 2024 prezantojnë llogaritë e pagueshme dhe të pagueshmet tjera dhe përbëhen nga si më poshtë:

| Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | Me 31 Dhjetor 2024 | Me 31 Dhjetor 2023 |
|------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Llogaritë e pagueshme              | 1,700              | 1,517              |
| <b>Gjithsej</b>                    | <b>1,700</b>       | <b>1,517</b>       |

## 6. FONDET

Më 31 Dhjetor 2024 prezantojnë fondet e bartura dhe rritjen apo zvogëlimin e fondeve të periudhës dhe përbëhen nga si më poshtë:

| Fondet                                                | Me 31 Dhjetor 2024 | Me 31 Dhjetor 2023 |
|-------------------------------------------------------|--------------------|--------------------|
| Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara | 42,150             | 4,194              |
| Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese    | 7,276              | 37,956             |
| Kthim donatorëve                                      | -                  | -                  |
| <b>Gjithsej</b>                                       | <b>49,426</b>      | <b>42,150</b>      |

## 7. TË ARDHURAT

Të ardhurat përbëhen të hyrat nga grantet, donacionet, vetkontributet dhe aktivitet ekonomike të cilat më datë më 31 Dhjetor 2024 përbëhen si më poshtë:

| Të ardhurat (projektet)                      | 1 Janar - 31 Dhjetor 2024 | 1 Janar - 31 Dhjetor 2023 |
|----------------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| KEC                                          | 14,536                    | -                         |
| Reach II                                     | -                         | 37,500                    |
| Prospect 3                                   | -                         | 5,780                     |
| SIDA                                         | 59,703                    | 54,009                    |
| ADA                                          | 53,455                    | 5,860                     |
| KKS                                          | 131,723                   | 6,682                     |
| VORAE                                        | 1,716                     | 10,464                    |
| MASHT                                        | 30,000                    | 53,949                    |
| <b>Të ardhura nga donacionet</b>             | <b>291,132</b>            | <b>174,244</b>            |
| Të hyra nga aktivitetet                      |                           |                           |
| <b>Të ardhurat nga aktivitetet ekonomike</b> | <b>-</b>                  | <b>-</b>                  |
| Të ardhurat tjera (vetkontributet)           | 377                       | 589                       |
| <b>Të ardhurat tjera</b>                     | <b>377</b>                | <b>589</b>                |
| <b>Gjithsej</b>                              | <b>291,509</b>            | <b>174,833</b>            |

## 8. SHPENZIMET PROGRAMORE

Shpenzimet programore prezantojnë shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt në zhvillimin dhe kryerjen aktiviteteve programore përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2024 të cilat përbëhen nga si më poshtë:

| Shpenzimet programore    | 1 Janar - 31 Dhjetor 2024 | 1 Janar - 31 Dhjetor 2023 |
|--------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Pagat dhe mëditjet bruto | 129,237                   | 18,549                    |
| Shpenzimet programore    | 72,020                    | 34,144                    |
| Shpenzimet tjera         | 7,624                     | -                         |
| <b>Gjithsej</b>          | <b>208,881</b>            | <b>52,693</b>             |

## 9. SHPENZIMET E ADMINISTRATËS DHE MENAXHMENTIT

Shpenzimet e administrates dhe menaxhmentit prezantojnë shpenzimet indirekte për mbështetjen e mbarrëvajtjes së aktiviteteve programore përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2024 të cilat përbëhen nga si më poshtë:

| Shpenzimet administrates dhe menaxhmentit | 1 Janar - 31 Dhjetor 2024 | 1 Janar - 31 Dhjetor 2023 |
|-------------------------------------------|---------------------------|---------------------------|
| Pagat dhe mëditjet bruto                  | 26,979                    | 69,268                    |
| Shpenzimet operative                      | 22,661                    | 9,749                     |
| Shpenzimet tjera                          | 24,912                    | 101                       |
| <b>Gjithsej</b>                           | <b>74,552</b>             | <b>79,118</b>             |
| <b>Shpenzimet tjera</b>                   | <b>800</b>                | <b>5,066</b>              |
| <b>Gjithsej</b>                           | <b>800</b>                | <b>5,066</b>              |

## 10. NGJARJET PAS DATËS SË PËRPILIMIT TË RAPORTEVE FINANCIARE

Menaxhmenti i OJQ-së është përgjegjës për të shpalosur ngjarjet që mundë të kenë ndikim në pasqyrat financiare, deri në ditën e perpilimit të këtijë raporti, ne nuk kemi marrë nga menaxhmenti i OJQ-së ndonjë rast apo ngjarje që mundë të ketë ndikim të mëvonshme pas datës së pasqyrës së pozicionit financiar dhe që kërkojnë rregullime në pasqyrat financiare ose shpalosje.

## 11. APROVIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim me 31.03.2025.

## Shtojca 1

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.